

AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE TE KOSOVES

Në pajtim me autoritetin që i është dhënë në nenin 17.b të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/24, të datës 1 Tetor, 2001 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/20, mbi autoritetin bankar dhe të pagesave të Kosovës, dhe nenit 3.3 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25 të datës 5 Tetor, 2001 mbi licencimin, mbikqyrjen dhe rregullat e kompanive të sigurimit dhe ndërmjetësuesve të sigurimit.

Me qëllim të zbatimit të nenit 42 të rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/25

Bordi Drejtues i Autoritetit Bankar dhe të Pagesave të Kosoves, në mbledhjen e mbajtur me 28 Mars, 2002 ka miratuar me sa vijon:

Rregullin 17 mbi Burimin e Produkteve Financiare

Neni 1

1. Shtrirja e Rregullit

Ky Rregull aplikohet për të gjitha kompanitë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit të licencuar nga BPK-ja

2. Autoriteti Ligjor

Ky rregull implementon Nenin 42, kapitullin VI (Qështjet Prudenciale) të rregullave të sigurimit.

3. Definicionet

Në këtë rregull termet e mëposhtme nënkuptojn:

“Produkte Burimore” apo “Burimore” është një mjet financiar apo përgjegjësi vlera e të cilit varet (apo buron) nga mjetet tjera përgjegjësitë apo indekset (mjetet themelore). Burimoret (Derivativat) janë kontrata financiare dhe përfshijnë një asortiment të gjerë të

instrumenteve, siç janë, avancimet, ardhmëria, opcionet, shkaktarët dhe pezullimet, autorizimet, shkëmbimet dhe përbërësit. Në këtë rregull, cdo produkt i strukturuar që ka efektin e burimores (derivative) mendohet të jetë produkt burimor.

“Boardi i Drejtorëve” nënkupton rangimin më të lartë të trupit drejtues të një Korporate të përbërë nga anëtarët të zgjedhur me votim të barabartë. Në këtë rregull termi “Bordi i Drejtorëve” i referohet:

a) Në raste të Korporatës apo kompanisë të themeluara dhe që vepron sipas ligjeve të Kosovës, Bordi i Drejtorëve e organizon vetën.

b) Në raste të kompanisë së huaj të inkuorporuar në juridiksion tjetër, por e cila është e licencuar për t’u marrë me biznesin e sigurimit në Kosovë, zyrtari i lartë i kompanisë, në zyret në Kosovë, i cili është banorë i Kosovës dhe është pranuar si i till nga BPK.

“Bordi” i referohet bordit të drejtorëve siç është definuar në rregull.

“Kompania” i referohet njerës apo të dyjave, kompanisë së sigurimeve apo kompanisë së ndërmjetësuesve.

“Rreziku i rrjedhjes së parave të gatshme” nënkupton rrezikun që shoqrohet me aftësinë e kompanisë për t’i financuar aktivitetet burimore (derivative), si në përballimin e pezullimeve për kontratat e ardhshme.

“Përbërja” është një kombinim i dy apo më shumë standardeve burimore(derivative) për të arritur një objektiv të caktuar.

“Rreziku i Kredisë” është rreziku të cilin homologu nuk do ta paguaj në afatet e kontratës burimore (derivative) dhe mundet eventualisht të mos i plotësoj obligimet e tij.

“Rrezikui likuiditetit” është rreziku të cilin kompania nuk do të mundet ta lëshoj apo shlyej pozitën e saj në transaksionet burimore (derivative) me apo qmime të tregut për shkak të tregut jo adekuat apo për shkak të përçarjes së tregut.

“Rreziku i tregut” është rreziku të cilit kompania i ekspozohet si rrjedhojë e levizjeve të kundërta në faktorë e ndryshëm, siç janë, aksionet, detyrimet, normat e kamatës, normat e këmbimit, qmimi i indeksit të klientit, etj. Kjo dëmton produktet financiare të tregut.

“Rreziku operacional” është rreziku i humbjeve të papritura, që rrjedhin nga mungesa e informimit të menaxhmentit, sistemit të kontrollit intern apo kompetencat në menaxhimin e burimeve (derivativave).

Neni 2

Investimet dhe Përdorimi i Burimeve (Derivativate)

1. Kufizimi në Transaksionin e Burimeve (derivativate)

Asnjë kompani e licencuar nuk mund të transaktoj apo të hyj në cfarë do lloj kontrate që përfshinë, produktete burimore (derivative) pa miratim të mëparshëm nga BPK-ja.

2. Kërkesa për miratim kërkohet nga BPK-ja:

Cdo kompani e licencuar që dëshiron të transaktoj ndonjë produkt burimor (derivativ) duhet ta dorëzoj planin apo propozimin për miratim në BPK. BPK-ja me lirinë e saj të veprimit, mund ta miratoj dhe të autorizoj një kompani për të hyrë në kontrat që përfshinë produkte të veqanta burimore (derivative), kur siguron se:

- a) Bordi i drejtorëve të kompanisë i dorëzon planin e investimeve të propozuara duke specifikuar kontratën burimore që synojn dhe produktet, duke ja bashkangjitur rezolutën e bordit që i ka miratuar transaksionet burimore të propozuara.
 - b) Asnjë mjet i kompanisë që ka të bëjë me provizionin teknik, llogaritë që përfaqësojnë minimumin e kërkuar të kapitalit dhe margjinën e aftësisë paguese, janë të caktuara apo përdorura për produkte burimore dhe kontrata.
 - c) Kompania ka në vend, politikë adekuate dhe efektive të formuluar dhe të miratuar nga bordi i drejtorëve për përdorimin e transaksioneve burimore (derivative). Politika duhet të jetë në përputhje me aktivitetet e biznesit të kompanisë, objektivat e tyre të përgjithshme investuese, mjetet/detyrimet, strategjia e menaxhmentit dhe tolerancën për rrezik. Politika duhet të adresoj elementet vijuese me kërkesë të BPK-së.
1. Qëllimin për të cilin është përdorur burimi (derivativi) dhe objektivin e veqantë të investimit të tij.
 2. Themelimi i përshtatshëm i strukturës së limiteve të zbuluara, të vetme dhe në total, për produkte burimore (derivative) të tilla duke marrë parasysh qëllimin e përdorimit të tyre dhe pasigurinë të shkaktuar nga tregu, kreditë, likuiditeti, parat e gatshme, dhe rreziku operativ dhe legal.
 3. Kufizimet në mbajtjen e llojeve të veqanta të burimeve (derivativate) siç janë ato ku ekspozimi i rrezikut nuk mund të matet si duhet dhe të kontrollohet, ku shtendosja e pozitës apo likuiditeti apo shitja e burimit (derivativit) mund të jetë i vështirë, ku verifikimi i çmimit të pavarur nuk është në dispozicion dhe bordi apo BPK-ja e sheh të arsyeshëm

duke marrë në konsideratë madhësinë e kompanisë dhe nivelin e biznesit.

4. Vija e përgjegjësisë për transaksionet e burimeve (derivativave) janë kjarhtë të strukturuar dhe të themeluar në pajtim me kualifikimin, integritetin dhe kompetencat teknike të cdo zyrtari të kompanisë apo punëtori i cili është involvuar në transaksionet e burimeve (derivativave).
- d) Kompania posedon me sistemin e menaxhimit të rrezikut, i aftë për të identifikuar, mat, kontrolluar dhe raportuar BPK-s dhe bordit, rrezikun e aktivitetit të kompanisë me burime (derivativa)
- e) Kompania posedon procedurën e kontrollit intern adekuat dhe efektiv
Për të siguruar se aktiviteti burimor (derivativ) monitorohet dhe kontrollohet në mënyrë të rregullt dhe se transaksionet të cilat hynë, janë plotësisht në pajtim me aprovimin e politikave dhe procedurave dhe në pajtueshmëri me të gjitha ligjet dhe rregullat e duhura.
- f) Kompania posedon personel të revizorit të mbrendeshëm, të kualifikuar, kompetent me orar të plotë dhe të pajisur mjaftë me njohuri teknike dhe të tregut mbi burimet (derivativat) dhe të aftë për të verifikuar dhe vlerësuar satndardet prudenciale të zbatueshme në transaksionet burimore (derivative) dhe në raportimin e kundërt të rrezikut bordit me kohë.
- g) Bordi i drejtorëve është i pajisur në mënyrë të arsyeshme me njohuri Adekuate dhe ekspertizë në kuptimin e çështjeve me rëndësi, që kanë të bëjnë përdorimin e burimeve (derivativave), dhe që cdo individ që bënë monitorimin dhe kontrollin e transaksioneve burimore (derivative) janë të kualifikuar dhe kompetent, dhe si shtesë të kenë kaluar kërkesat e përshkruara të BPK-së si i përshtatshëm.
- h) Bordi i drejtorëve e bënë rishikimin tremujor (koincident me tremujorin e Kompanisë) të polisave burimore të kompanisë dhe procedurave për të siguruar adekuatitetin e saj dhe efektivitetin, duke marrë parasyshtë aktivitetin e kompanisë, rrezikun e gjithmbarshëm të tolerueshëm dhe kushtet e tregut; dhe për 15 ditë për të përcjell fundin e cdo tremujori, i dorëzon BPK-s, rishikimin dhe të gjeturat në të, shkallën e besnikërisë për polisat dhe procedurat e aprovuara, përgjegja në efektin financiar të kompanisë dhe masat e ndërmarra nga bordi lidhur me to.
- i) Kompania është në pajtim me provizionet e rregullores së sigurimeve, këto rregulla dhe direktiva të BPK-së konsistojnë në një gjë të till.

3. Tërheqja apo Revokimi i Miratimit të BPK

BPK-ja në cdo kohë, mund ta tërheq apo revokoj miratimin e saj të mëhershëm, me të cilin e ka autorizuar kompaninë për t'i përdorur burimet (derivativat) dhe /apo ka hyrë në kontratë që përfshinë burimet (derivativat), kur kupton se:

- a) Kompania po transakton burime (derivativa) në ate mënyrë e cila nuk është në pajtim me kriteret e përshkruara nga bordi apo direktivat e BPK në shfaqjesim me mbikëqyrjen e saj.
- b) Nëse raporti i bordit të drejtorëve i përshkruar në paragrafin h) të alinesë 2, nuk i është dorëzuar BPK-së siç është kërkuar me këtë rregull; apo raporti i dorëzuar dështon për të siguruar informatat adekuate për BPK-në, për të bërë vlerësim të arsyeshëm të transaksioneve të burimeve (derivativave), pozitën dhe ekspozimin e kompanisë.
- c) Për çfarëdo arsye tjetër për të cilën BPK-ja e konsideron të nevojshme për të mbrojtur dhe ruajtur interesat e aksionarve të kompanisë.

Neni 3 Pajtimi

1. Zbulimi i Kërkesave

Cdo kompani e licencuar nga BPK-ja për të përdor burime (derivativa) apo për të hyrë në kontrat që përfshijnë burime (derivativa) duhet të zbulohet, në raportin e saj vjetor të revizorit dhe në të gjitha raportet e saj tremujore dhe vjetore financiare të cilat i'a dorëzon BPK-së, ku duhet të përfshihen informatat kualitative dhe kuantitative të kompanisë lidhur në aktivitetet burimore (derivative). Në harxhime të kompanisë, këto zbulime duhet të publikohen në gazetën të qarkullimit të përgjithshëm në Kosovë, Brenda 10 ditësh nga data e dorëzimit të tyre në BPK.

2. Efekti i Mosaprovimit nga BPK-ja dhe mos Zbulimi

Nëse plani i propozuar për t'i përdor transaksionet burimore (derivative) nuk miratohet, BPK-ja do ta njoftoj kompaninë me shkrim, duke specifikuar objektivat e saj. Nëse dhe derisa kompania të mos i marr parasyshë objektivat që kërkohen nga BPK-ja plani i propozuar nuk do të miratohet. Tërheqja apo revokimi i miratimit të mëhershëm që e ka autorizuar kompaninë për të përdorur transaksionet burimore (derivative) e ka forcën dhe efektin e mosmiratimit.

Nëse kompania ekzekuton apo implementon ndonjë transaksion burimor (derivativ) pa miratimin e BPK-së; apo nëse kompania dështon për të bërë zbulimin e duhur të përshkruar në këtë rregull:

- a) Licenca e kompanisë mund të suspendohet apo të revokohet dhe BPK mund të marr hapa të tjerë të nevojshëm, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Sigurimeve dhe këtyre rregullave.

- b) Në lirinë e veprimit të BPK, nëse asnjë pjesë e mjeteve të kompanisë, nuk Korrespondojn me dispozitat teknike të tyre dhe shumat që përfaqsojnë minimumin e kërkuar të kapitalit dhe marginën e aftësisë paguese janë ekspozuar produkteve burimore (derivative) apo kontratave dhe nëse justifikon për nga natyra dhe zgjerimin e transaksioneve burimore (derivative), licenca e kompanisë mund të jetë subjekt i kushteve të caktuara siç janë, por jo të limituara në përshkrimin e periudhës së caktuar kohore për kompanitë për të shtendosur dhe prirur pozitat burimore (derivative) të tyre, kufizimet në llojin e obligimeve dhe sigurimeve si investime të lejuara, kufizimet të nënshkruesve të kompanisë dhe pranimit të rrezikut me apo ndonjë kusht tjetër ashtu siç e mendon në mënyrë dhe rrethana të përshtatshme BPK-ja.

Neni 4 **Hyrja në fuqi**

Ky rregull, do të hyj në fuqi me 1 Prill, 2002

David Weatherman
Ushtrues i Detyrës së Drejtorit Gjeneral